



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

SHTOJCA 13

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Maliq më 24.10.2018

Për: **“KORSEL” shpk**

“Korsel ” shpk :

Adresa : Korçë, Objekt Privat, Bulevardi Fan. S. Noli, Përballë Supermarket " Elisabet"

NIPTI: J64104124G

Procedura e prokurimit: : **PROCEDURË E HAPUR / SHËRBIME / SISTEM ELEKTRONIK**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-55053-03-09-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **”Shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit”** / Afati i kontratës: **5 (pesë) vjet nga data e nënshkrimit të kontratës**

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.11 datë 19.03.2018

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomike më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

I - Operatori ekonomik (OE) “ KORSEL” shpk

“ KORSEL” shpk : NIPT-i J64104124G

Vlera e ofruar e ofertës është 136 398 947.25(njëqindetridhjetëegjashtëmilion e treqind e nëntëdhjetë e tetëmijë e nëntëqindedyzeteshtatë pikë njëzetepesë)) lekë pa tvsh

II - Operatori Ekonomik (OE) “ Pastrim Silvio ” shpk

“ Pastrim Silvio ” shpk NIPT-i : K91413010N

Vlera e ofruar e ofertës është 125 682 435.25 (njëqind e njëzet e pesë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e dymijë e katërqind e tridhjetë e pesë pikenjëzetepesë) leke pa tvsh

III- Operatori Ekonomik (OE) “ REJ ” shpk

- *“ REJ ” shpk : NIPT-i : J93711608Q*

- *Vlera e ofruar e ofertës është 119 234 123 (njëqind e nëntë mbëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë e katermijë e njëqind e njëzet e tre) lekë pa tvsh*

IV- Operatori Ekonomik (OE) “ SILVER ” shpk

“ SILVER ” shpk : NIPT-i : ?????

Adresa: Bulevardi “Rinia”, Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026www.bashkiamaliq.gov.al

Vlera e ofruar e ofertës është 137 000 000 (një qind e tridhjetë e shtatë milion) lekë pa tvsh

U skualifikuan:

A - Operatori ekonomik “ REJ ” shpk

Plotëson kërkesat e përgjithshme per kualifikim

Nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim sepse :

1 - Ka mangësi në plotësimin e kriterit për kontratat e ngjashme të realizuara në tre vitet e fundit .

- Operatori ekonomik “Rej” sh.p.k. për të vërtetuar se ka kryer eksperiencë të mëparshme të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, ka paraqitur dy kontrata, njera me ish Komunën Udenisht dhe tjetra është lidhur me Bashkinë Pogradec ndërmjet bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rej” sh.p.k. & “Shpresa” sh.p.k., në të cilën nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me përqindjen që ka secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rej” sh.p.k. & “Shpresa” sh.p.k., në mënyrë që të përlllogaritet pjesa e shërbimeve të kryera nga shoqëria “Rej” sh.p.k. e që rrjedhimisht të verifikohet nëse e përmbush kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

- Kontrata e lidhur me Bashkinë Pogradec date 16.01.2015 , ka të përcaktuar se si operator ekonomik është bashkimi i shoqërive “Rej” sh.p.k. dhe “Shpresa” sh.p.k., dhe si e tillë duhet që të vërtetohet sa është pjesa e përqindjes së marrë përsipër prej secilit prej këtyre anëtarëve, ndërkohë që edhe në vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Pogradec Nr.4634/1 prot. , date 26.06.2018 nuk jepet asnjë e dhënë në lidhje me këtë përqindje, por thuhet se kjo kontratë është realizuar me sukses dhe I vetëm nga shoqëria “Rej” sh.p.k. (ne kundërshtim me LPP dhe VKM Nr. 914 te ndryshuar neni 74, pika 2 , Bashkimi I Operatoreve ekonomike ,) edhe pse në kontratën e lidhur është përcaktuar qartë që kjo kontratë lidhet me bashkimin e operatorëve ekonomikë dhe jo vetëm me shoqërinë “Rej” sh.p.k.

Per verifikimin e dokumentacionit te dorezuar nga OE „ Rej „ shpk mbi kontraten e zbatimit të shërbimit të pastrimit të qytetit Pogradec, KVO ju drejtua Bashkisë Pogradec me shkresë Nr. 2850 prot, datë 24.07.2018- Kërkesë për informacion .

Me shkresë Nr.5656/1 prot , datë 27.07.2018 , protokolluar në Bashkinë Maliq me Nr.2850/1 datë 02.08.2018, KVO merr përgjigjen e Bashkisë Pogradec e cila thekson se **Në datën 16.01.2015 është lidhur kontrata e shërbimit me objekt : „ Pastrim, grumbullim dhe largim i mbeturinave publike të qytetit të Pogradecit“ .Kontrata është lidhur me B.O.E , „ REJ „ shpk dhe „ Shpresa“ shpk, përfaqësuar nga „ Rej“ shpk .**

Shkresa e Bashkisë Pogradec nuk qëndron sepse në një kohë që kontrata , datë 16.01.2015 është firmosur nga të dy Operatorët ekonomikë, Bashkia Pogradec thekson se është përfaqësuar nga „Rej“ shpk ne kundërshtim me LPP dhe VKM Nr. 914 te ndryshuar neni 74, pika 2 , Bashkimi i Operatoreve Ekonomike

2 - Ka mangësi në përmbushjen e kriterit teknik 3.2.11 kapacitetet teknike për realizimin me sukses të kontratës.

Kandididati/ operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet e mëposhtme teknike që

nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Lista e makinerive që duhet të disponojë operatori ekonomik të përmbledhura në tabelën e mëposhtme:

- *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasi të përkatëse për mjetet e disponueshme*
- *Ne rast se mjetet nuk janë ne pronësi apo me qera mund të paraqiten Akt Marrëveshje porosie/Kontratë e Porosie/kontrate leasing/ ose Marrëveshje për shitjen me kusht të mjeteve.*
- *Kontratat dhe marrëveshjet e sipercituara duhet të jenë lidhur përpara noterit dhe duhet të përmbajnë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës /marrëveshjes si dhe afatin për ekzekutimin e saj.*
- *Nuk ka deklarate me shkrim për disponimin e mjeteve **ku të specifikohet** lloji I mjetit, për se do përdoret , targa e tij , të dhënat teknike të mjeteve , me qira /në pronësi/apo lloj tjetër*
- *Në kontratën e shitjes me kusht por edhe në kontratën e qirasë , nuk përcaktohet lloji I mjetit dhe të dhënat teknike të tyre ashtu siç kërkohet dhe nuk e përcaktojmë dot llojin e mjeteve sipas përcaktimeve të specifikimeve teknike në dst .*

3– Ka mangësi në përmbushjen e pikës 3.2- Kapacitetet teknike- , pika 9/a :

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (e vlefshme).

- a. Leje mjedisore të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për pastrimin, larje rruges, fshirje rrugesh . **(Kodi III.1.A)**
- *Mungon leja mjedisore , kodi III.1.A sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor*
 - *Leja e paraqitur PN -2521-04-2016 është “Stacion transferimi për mbetje jot ë rezikshme” dhe leja tjetër PN -5796-09-2017 është “ Pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve ,paketimeve ose kontinjereve në mënyrë që të ripërdoren.*

4 – Ka mangësi në përmbushjen e pikës 3.2 Kapacitetet teknike , pika 5 :

Operatori ekonomik të ketë të punësuar Mjekun e shoqërisë , e vertetuar kjo me

- Kontratë pune (e vlefshme),
- Urdhër Mjeku,
- CV,
- librezë pune,
- diplomën përkatëse.
- Te jete në listepagesa për periudhën janar 2017- janar 2018.
- *Mjekja Ersjona Topalli nga verifikimi I listë pagesave është e me lejë lindje për periudhën Gusht 2017- Janar 2018*

B - Operatori ekonomik “ Pastrime Silvio ” shpk

Plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim

Nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim sepse :

1 - Ka ndryshuar zerat e preventivit

- *Oferta ka devijime në volumet punës të përcaktuara në preventivin e dhënë nga Autoriteti Kontraktor dhe konkretisht .*
- *pika II e preventivit - Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve urbane*

Maliq -është 10 024.725 ton dhe është bërë 10 024.73 ton

Pirg është 7 875.605 ton dhe është bërë 7 876.61 ton

2 - Ka mangësi në plotësimin e kriterit për kontratat e ngjashme të realizuara në tre vitet e fundit sipas pikes 3.2/1

Për të vërtetuar se ka kryer eksperiencën të mëparshme të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, ka paraqitur nëntë kontrata vlera e realizuar në total është 48 417 417 leke ,(nga 55 856 860 lekë shërbime të kërkuara), kryesisht evadim të mbetjeve urbane nëpër spitaleKonkretisht :

Kontrata me spitalin Hygeia ,ka realizuar vlerën 3 674 165 lekë

Në kontratën e zbatimit me Bashkinë Peqin nuk jepet % e bashkëpunimit , mungon vërtetimi për realizimin me sukses të kontratës , ka mospërputhje midis situacionit dhe faturës. Kontrata me Bashkinë Peqin nuk është e rregullt sepse i mungon vërtetimi për realizimin me sukses të kontratës . Kontrata datë 21.05.2014 është lidhur midis bashkisë Peqin dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Pastrime Silvio “ shpk & “Fusha “ shpk . Në këtë kontratë nuk jepet asnjë e dhënë për % e bashkëpunimit , por vlera e kontratës është 6 904 157 lekë pa tvsh në vit , ku ka fatura dhe situacioneve në vlerën 6 660 755 lekë vetëm për vitin 2015, te pa firmosur nga Operatori tjetër “ Fusha” shpk . Prandaj kjo kontratë nuk merret parasysh .

Kontrata me Ambasadën Italiane ka realizuar sipas kërkesave vlerën 330 000 lekë

Kontrata me Qendrën Kombëtare të Trasfuzionit të Gjakut , ka realizuar vlerën 459 395 lekë

Kontrata me Bashkinë Ura Vajgurore , Nr.1176/12 datë 01.09.2016 e lidhur midis Bashkisë Ura Vajgurore dhe bashkimit të Operatorëve ekonomikë “ Pastrime Silvio”shpk & “ Ed Konstruksion”shpk ku 72 % të bashkëpunimeve i ka “ Pastrime Silvio”shpk .Për pjesën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave kontrata është 20 802 119 leke me tvsh në vit dhe jo 25 883 879 siç është përcaktuar në formularin e vlerësimit .Vërtetimi datë 21.09.2017 i bashkisë Ura Vajgurore tregon se viti i parë është realizuar kontrata dhe është rinovuar pra vlera e kontratës për vitin 2016 është 6 778 165 me tvsh/ 20 % tvsh= 5648471 x 72% = 4 066 899 lekë pa tvsh vlera e kontratës për vitin 2017 është 20802119 me tvsh /20 % tvsh =17335099 x 72 % =12481271 leke pa tvsh , pra vlera është 16 548 170 lekë

Kontrata me spitalin Mbretëresha Geraldinë ka realizuar vlerën 624 498 lekë

Kontrata me Bashkinë Lezhë ka realizuar vlerën 24 459 141 lekë

Kontrata me spitalin Koço Glozheni ka realizuar vlerën 828 352 lekë

Kontrata me ambasadën Amerikane ka realizuar vlerën 1 493 750 lekë

Për të gjitha kontratat e realizuara rezulton se vlera është 48 417 417 lekë

3 – Mungon drejtuesi teknik :

Adresa: Bulevardi “Rinia”, Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026www.bashkiamaliq.gov.al

1. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik, i cili duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- i. Librezë pune
 - ii. CV
 - iii. Kontrate pune midis tij dhe Operatorit ekonomik (e vlefshme).
 - iv. Te jete ne liste pagesat e operatorit ekonomik per periudhen janar 2017-janar 2018.
- Ing. e mjedisit Anila Gishti me kontratën Nr.711. Rep datë 12.03.2018 dhe afat deri në 12.03.2020 nuk ka experience pune në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit (sipas CV dhe sipas librezës së punës), gjithashtu nuk është në listë pagesat e Operatorit për periudhën e kërkuar.
 - Ing. Kimist Gani Deliu është studiues e vlerësues ne fushen e ndotjes së ajrit, e jo drejtues teknik me experience pune ne fushen e ofrimit të shërbimit të pastrimit (sipas CV dhe sipas librezës së punës e cila është deri në 2014 si specialist ne ARM Tiranë)

4 - Ka mangësi ne përmbushjen e kriterit teknik 3.2.11 kapacitetet teknike për realizimin me sukses të kontratës.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar :

Kandididati/ operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet e mëposhtme teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Lista e makinerive që duhet të disponojë operatori ekonomik të përmbledhura në tabelën e mëposhtme:

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe të bëjë deklarimin e adresës së saktë të vendodhjes së mjeteve me qëllim verifikimin e tyre.

Operatori Ekonomik “Pastrime Silvio” ka paraqitur katër kontrata qiraje për mjetet dhe dy mjete në pronësi të tij por në dokumentat e paraqitura ka pasaktësi midis cilësimit të mjeteve dhe dokumentave në brendësi të tyre .Mjetet cilësohen – makinë plerash 10 t dhe në fakt është 3.2 ton, cilësohen mjete 5 ton dhe janë mjete teknologjike 11 ton etj .Kjo sepse :

- Mungon deklarata për disponueshmërinë e mjeteve , **ku të specifikohet mjeti** , lloji i tij , targa ,te dhenat teknike , me qira / pronesi ,apo lloj tjetër

- Në deklarata nuk përcaktohet vendndodhja e mjeteve me qëllim verifikimin e tyre nga ana e Autoritetit Kontraktor sipas dst.

C - Operatori ekonomik “ SILVER ” shpk

Adresa: Bulevardi “Rinia”, Maliq, Korçë Tel. & Fax. 0861 2 2026www.bashkiamaliq.gov.al

Nuk plotëson kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikim sepse :

Ka paraqitur vetëm një dokument (formularin e ofertës)

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, njoftojmë operatorin ekonomik “**KORSEL**” shpk me adresë : Korçë, Objekt Privat, Bulevardi Fan. S. Noli, Përballë Supermarket " Elisabet" NIPTI: J64104124G se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 136 398 947.25(*njëqind e tridhjetë e gjashtëmilion e treqind e nëntëdhjetë e tetëmijë e nëntëqind e dyzet e shtatë pikë njëzet e pesë*)) *lekë pa tvsh* ; pikët totale të marra [_____] **është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [BASHKIA MALIQ, BULEVARDI RINIA, MALIQ, KORÇË] **sigurimin e kontratës**, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, **brenda 5 (pesë) ditëve** nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **S’KA** siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë : **02.08.2018**

Ankesa:

I.Ankesa me Nr.3052 Prot., datë 08.08.2018 nga operatori ekonomik “REJ” shpk ka marrë përgjigje në datë 15.08.2018 me Nr.3052/1 Prot

II.Ankesa me Nr.3068 Prot., datë 09.08.2018 nga operatori ekonomik “PASTRIME SILVIO” shpk ka marrë përgjigje në datë 16.08.2018 me Nr.3068/1 Prot

[Titullari i autoritetit kontraktor]

KRYETARI I BASHKISE

GËZIM TOPÇIU
